



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government



ALE NK
Adult Learning and Education
Network in Kosovo



DVV International

Education for Everyone. Worldwide.
Lifelong.

JAVA E TË MËSUARIT GJATË GJITHË JETËS NË KOSOVË (JMGJJ) 2025

LIFELONG LEARNING WEEK (LLLW)

Financuar nga:



Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development

BMZ

DVV International Country Office Kosovo
Str. Rexhep Mala, Nr. 26
Prishtina 10 000 Kosovo

Përmbajtja

<u>Hyrje</u>	<u>2</u>
<u>Aktivitetet kryesore të Javës</u>	<u>3</u>
<u>E Hënë, 24 Nëntor 2025 - Hapja Zyrtare në Prishtinë, Prizren dhe Pejë</u>	<u>3</u>
<u>E Martë, 25 Nëntor 2025 - Promovimi i JMGJJ në Mitrovicën e Jugut dhe Kamenicë.....</u>	<u>13</u>
<u>E Mërkurë, 26 Nëntor 2025 - Promovime në Ferizaj dhe Gjakovë dhe Podcast-e</u>	<u>20</u>
<u>E Enjte, 27 Nëntor 2025 - JMGJJ në Podujevë si dhe Podcast.....</u>	<u>26</u>
<u>Përfundim</u>	<u>31</u>
<u>Rekomandime të dala nga Java e Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) 2025</u>	<u>32</u>

Hyrje

Java e Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) u realizua me sukses përgjatë katër ditëve 24 - 27 nëntor 2025, duke ofruar një seri aktivitesh gjithëpërfshirëse të dedikuara promovimit të kulturës së të nxënit të vazhdueshëm në mbarë Kosovën.

E organizuar nga Rrjeti për Arsimin e të Rriturve - ALE NK, në bashkëpunim dhe me mbështetje nga DVV International në Kosovë, kjo javë mobilizoi institucione qendrore e lokale, organizata të shoqërisë civile, ofrues të trajnimeve, si dhe qytetarë nga komuna të ndryshme të vendit.

Gjatë kësaj jave, theksi u vendos te roli i të mësuarit gjatë gjithë jetës si një shtyllë qenësore për zhvillimin personal, profesional dhe shoqëror, vecanërisht në një kohë me ndryshime të shpejta digjitale, teknologjike dhe ekonomike. Programi i JMGJJ 2025 nënvizoi rëndësinë e një qasjeje të integruar që kombinon arsimin formal, joformal dhe informal, duke synuar ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme, konkurruese dhe të orientuar drejt zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Java e Mësimit Gjatë Gjithë Jetës në Kosovë shënon një iniciativë kombëtare të rëndësishme në përhapjen e kulturës së të nxënit të vazhdueshëm. Kjo javë synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi rolin e arsimit në çdo moshë dhe në çdo formë, qoftë formal, joformal apo informal.

Në një realitet të karakterizuar nga transformime të shpejta teknologjike, shoqërore dhe ekonomike, të mësuarit gjatë gjithë jetës përbën një investim të domosdoshëm për zhvillimin personal dhe profesional, si dhe për fuqizimin e komuniteteve tona.

Gjatë datave 24 - 27 nëntor, në disa komuna të Republikës së Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Vushtrri, Mitrovicë e Jugut, Kamenicë, Ferizaj, Vushtrri, Gjakovë dhe Podujevë) u zhvilluan aktivitete promovuese dhe prezantime të ofertave edukative. Aktivitetet u mbajtën si në ambientet e institucioneve anëtare të rrjetit, ashtu edhe në sheshet qendrore të komunave, ku u shpërndanë materiale informuese, broshura, fletëpalosje dhe u organizuan prezantime nga institucione shtetërore, OJQ dhe organizata të fushës së arsimit dhe zhvillimit profesional.

Katër ditët e JMGJJ 2025 përfshinë aktivitete të ndryshme promovuese, informuese dhe ndërgjegjësuuese, të fokusuara te të rinjtë, të rriturit dhe të gjitha kategoritë e interesuara për zhvillim personal dhe profesional.

Aktivitetet kryesore të Javës

E Hënë, 24 Nëntor 2025 - Hapja Zyrtare në Prishtinë

- *Fjalë përshëndetëse nga përfaqësues të MASHTI, MKRS, DVV International dhe ALE NK*
- *Prezantimi i objektivave, rëndësisë dhe programit gjatë Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës*
- *Aktivitete promovuese në sheshet kryesore të Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës*
- *Ligjëratë dhe debat online nga Kolegji European i Kosovës - ECK "Përparësitë dhe sfidat e Arsimit për të Rritur dhe AAP në Kosovë"*

Hapja e Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës në Kosovë u mbajt në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve lokale dhe qendrore, përfaqësuesit e institucioneve partnere që mbështesin Arsimin e të Rriturve dhe Arsimin Gjatë Gjithë Jetës në Kosovë.

Hapjen zyrtare të Javës e bëri znj. Ryve Prekorogja - Udhëheqëse e Divizionit për Arsimin Gjatë Gjithë Jetës dhe Koordinatore Kombëtare për Arsimin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës, njëkohësisht edhe kryetare e Bordit të Rrjetit ALE NK. Në fjalën e saj përshëndetëse, ajo theksoi vizionin strategjik të ministrisë për forcimin e ndërthurjes ndërmjet arsimit formal dhe atij joformal, si dy shtylla plotësuese në promovimin e mësimit gjatë gjithë jetës.

Znj. Prekorogja nënvizoi rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët, avancimit të aftësive profesionale sipas kërkesave të tregut të punës, si dhe rolin që partneritetet ndërinstitucionale, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe rrjetet profesionale, luajnë në zhvillimin e një ekosistemi të qëndrueshëm për të nxënëit gjatë gjithë jetës. Ajo ftoi akterët e pranishëm të kontribuojnë në fuqizimin e iniciativave që nxisin zhvillimin personal, profesional dhe shoqëror në nivel kombëtar.

Ndërkaq, z. Xhevat Bajrami - Drejtor i Departamentit të Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi rolin thelbësor të rinisë dhe kulturës në nxitjen e mësimit aktiv dhe gjithëpërfshirës. Ai potencoi se të rinjtë përfaqësojnë potencialin më dinamik të shoqërisë dhe se investimi në edukimin e tyre formal, joformal dhe kulturor është i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ai gjithashtu nënvizoi rëndësinë e rolit të MKRS-së, e cila, në partneritet me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet arsimore, mbështet iniciativat që promovojnë të nxënëit gjatë gjithë jetës si një proces të hapur dhe të përfshirë për të gjithë

Z. Ramadan Alija - Drejtor i DVV International në Kosovë, mori fjalën si përfaqësues i organizatës që ka kontribuar në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë në zhvillimin e arsimit të të rriturve në

DVV International Country Office Kosovo
Str. Rexhep Mala, Nr. 26
Prishtina 10 000 Kosovo

vend. Ai rikujtoi angazhimin e DVV International në ngritjen e kapaciteteve profesionale, fuqizimin e institucioneve dhe mbështetjen e politikave që promovojnë të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Në adresimin e tij, z. Alija theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore, rrjeteve profesionale dhe sektorit civil për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit të të rriturve, duke vlerësuar se ky sektor mbetet një komponent kyç për zhvillimin personal, ekonomik dhe social të qytetarëve. Ai ripërsëriti gatishmërinë e DVV International për të vazhduar mbështetjen në projekte dhe iniciativa që i mundësojnë çdo individ të ketë qasje në mundësi cilësore për të mësuar dhe për t'u zhvilluar në çdo fazë të jetës.

Ndërkaq, në tendat e hapura për publikun në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë u organizua promovimi i programeve arsimore dhe informuese nga institucione publike, organizata joqeveritare dhe qendrat trajnuese. Pjesëmarrëse në këtë aktivitet ishin: Qendra e Aftësimit Profesional (QAP), Qendra e Kompetencës (QK) “Shtjefën Gjeçovi”, Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK), DVV International dhe EPAL Kosovo. Këto institucione prezantuan ofertat e tyre trajnuese, platformat informuese dhe programet mbështetëse që synojnë të rrisin mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për qytetarët e të gjitha grupmoshave.



Foto 1: Hapja zyrtare e JMGJJ në sheshin “Zahir Pajaziti” Prishtinë



Foto 2: Hapja zyrtare e JMGJJ në sheshin “Zahir Pajaziti” Prishtinë



Foto 3: Hapja zyrtare e JMGJJ në sheshin “Zahir Pajaziti” Prishtinë



Foto 4: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Prishtinë

Në kuadër të Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës, OJQ THY dhe YALEC Prizren, në bashkëpunim me Qendrën e Kompetencës “11 Marsi”, Qendrën e Kompetencës dhe Qendrën e Aftësimit Profesional, organizuan aktivitete informues në sheshin e qytetit të Prizrenit. Qytetarëve u prezantuan programet, trajnimet dhe mundësitë zhvillimore që këto institucione u ofrojnë të rinjve dhe të rriturve, duke i afruar ata më pranë mundësive për zhvillim personal dhe profesional. Aktiviteti u pasurua me një tabelë interaktive, e cila u shndërrua në një hapësirë dinamike bashkëbisedimi. Qytetarët patën mundësinë të shprehnin idetë, pyetjet dhe interesimin e tyre për programet arsimore dhe profesionale, duke krijuar një atmosferë të gjallë, kreative dhe gjithëpërfshirëse. Ky aktivitet synoi të promovojë qasjen aktive të komunitetit ndaj mundësive të mësimit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit profesional në Prizren.



Foto 5: Tabela interaktive - Prizren

Gjithashtu, OJQ THY dhe YALEC Prizren (Youth and Adult Learning and Education Centre - Prizren), si anëtare e rrjetit ALE NK, gjatë gjithë javës realizuan aktivitete edukativo-arsimore të përshtatura me nevojat e komunitetit lokal. Qendra u shndërrua në një platformë ku të rinjtë dhe të rriturit mund të ndjekin pasionet e tyre, të zgjerojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësi të reja në fusha të ndryshme.

Mësimi gjatë gjithë jetës përbën një komponent të rëndësishëm për zhvillimin e një shoqërie moderne dhe demokratike. YALEC Prizren luan një rol kyç në këtë vizion, duke kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e ofertave arsimore me cilësi të lartë për të rinjtë dhe të rriturit, duke përfshirë kurse për aftësim profesional, zhvillim personal, edukim qytetar dhe kulturor.

Ky aktivitet dhe aktivitete tjera paralele që janë zhvilluar gjatë JMGJJ theksojnë rëndësinë dhe rolin e qendrës në komunitet në promovimin e arsimit dhe fuqizimin e qytetarëve përmes mësimi të vazhdueshëm.



Foto 6: Promovimi i Javës së Mësimi Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Prizren

Në po të njëjtën ditë, në Sheshin “Skënderbeu” në Pejë u organizua aktivitet promovues për mësimin gjatë gjithë jetës, ku qytetarëve iu ofruan materiale informuese dhe u prezantuan mundësi të ndryshme arsimore dhe profesionale. Në aktivitet morën pjesë institucione dhe organizata të ndryshme, përfshirë: KVRL / YALEC Pejë, Qendra e Aftësimit Profesional (QAP) Pejë, IAAP “Mithat Frashëri” Gurakoc - Istog, IAAP “Fehmi Agani” Klinë, Local Democracy Agency.



Foto 7: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Pejë

Pjesëmarrësit prezantuan programet e tyre edukative dhe trajnimet profesionale, duke ofruar informacion të detajuar për të gjitha grupmoshat dhe duke krijuar një hapësirë interaktive për qytetarët, ku ata mund të informoheshin dhe të angazhoheshin aktivisht mbi ofertat arsimore dhe mundësitë e zhvillimit profesional në rajon.



Foto 7: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Pejë



Foto 8: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Pejë

Në këtë aktivitet, KVRL / YALEC Pejë kishte rol të veçantë, duke promovuar programet dhe trajnimet e saj për të rinjtë dhe të rriturit, si dhe duke ofruar informacione mbi mundësitë për zhvillim personal, profesional dhe përfshirje sociale. Përveç shpërndarjes së materialeve informuese, stafi i YALEC Pejë krijoi një hapësirë interaktive ku qytetarët mund të konsultoheshin direkt për regjistrimin në kurset ekzistuese, si dhe për mundësitë e ardhshme të trajnimeve. Ky aktivitet theksoi rolin e YALEC Pejë si një qendër referimi për mësimin gjatë gjithë jetës në rajon, duke kontribuar në fuqizimin e qytetarëve dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive në programe arsimore dhe profesionale.



Foto 9: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Pejë



Foto 10: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Pejë

Nga ora 10 deri në ora 11 u mbajt një ligjërata dhe debat online me temën “*Përparësitë dhe sfidat e Arsimit për të Rritur dhe Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë*”, e organizuar nga Kolegji European i Kosovës - ECK. Gjatë diskutimit u trajtuan çështje kyçe që lidhen me zhvillimin e arsimit për të rritur, rolin e programeve të aftësimin profesional, sfidat institucionale dhe nevojat e tregut të punës. Pjesëmarrësit shkëmbyen përvoja dhe rekomandime praktike, duke theksuar rëndësinë e reformave të qëndrueshme dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për të përmirësuar qasjen dhe cilësinë e programeve të të mësuarit gjatë gjithë jetës.



Foto 11: Ligjëratë dhe debati online nga ECK

Si përfundim i aktiviteteve të ditës, u theksua rëndësia thelbësore e arsimit për të rritur dhe roli i tij i pazëvendësueshëm në zhvillimin e kapitalit njerëzor. U nënvizua se investimi në aftësimin dhe riaftësimin e qytetarëve kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e punësueshmërisë, përfshirjes sociale dhe zhvillimit ekonomik, duke e bërë të mësuarit gjatë gjithë jetës një prioritet strategjik për shoqërinë

E Martë, 25 Nëntor 2025 - Promovimi i Mësimit Gjatë Gjithë Jetës

- *Aktivitetet në sheshet e Mitrovicës së Jugut dhe Kamenicës*
- *Prezantimi i programeve edukative nga OJQ-të dhe institucionet partnere*
- *Interaktiviteti me qytetarët dhe shpërndarja e materialeve informuese*
- *Podcast nga YALEC Prizren / OJQ THY*

Gjatë ditës së martë, aktivitetet e Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës u zhvilluan në disa lokacione të rajonit, duke përfshirë Mitrovicën e Jugut (sheshi i këmbësorëve) dhe Kamenicën (sheshi "Metush Krasniqi"). Në këto aktivitete, përfaqësues komunalë mbajtën fjalë rasti, ndërsa institucione dhe OJQ lokale prezantuan ofertat e tyre arsimore dhe mundësitë e trajnimit profesional për të rinj dhe të rritur. Për qytetarët u shpërndanë broshura, fletëpalosje dhe

materiale të tjera informuese, duke krijuar një mundësi për informim të drejtpërdrejtë dhe bashkëbisedim mbi programet e ndryshme arsimore.

Në Mitrovicën e Jugut morën pjesë institucionet dhe organizatat e mëposhtme: SHMLT “Arkitekt Sinani”, Qendra e Aftësisimit Profesional (QAP), OJQ Hareja / YALEC, Coding Training Academy. OJQ Hareja / YALEC Vushtri, poashtu kontribuan në aktivitetet e Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) në Mitrovicë. Gjatë këtij eventi, ata prezantuan programet dhe aktivitetet e qendrës, të cilat synojnë të rrisin ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe përfaqësuesve institucionalë për rëndësinë e mësimit gjatë gjithë jetës. Qendra ofron mundësi të vazhdueshme zhvillimi për të gjitha grupmoshat dhe në të gjitha fushat e jetës, duke promovuar përfshirje dhe edukim cilësor për komunitetin. Qendra YALEC Vushtri zhvilloi një sërë trajnimesh dhe kursesh, përfshirë Gjuhën Gjermane, Edukimin Shëndetësor & Aerobikën, Rrobaqepësinë, Orientimin në Karrierë & Soft Skills si dhe një podcast tematik, duke fuqizuar të rinjtë dhe të rriturit në kuadër të Javës së të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës.



Foto 12: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Mitrovicën e Jugut

Foto 13: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Mitrovicën e Jugut



Foto 14: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) në OJQ Hareja / YALEC Vushtri



Ndërkaq, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), gjithashtu anëtare e Rrjetit për Arsimin e të Rriturve në Kosovë (ALE-NK), ishte nikoqire e panairit në kuadër të Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës. Aktiviteti ofroi një hapësirë për informim dhe prezantim të programeve që nxisin mësimin, kualifikimin dhe aftësimin profesional, me pjesëmarrjen e drejtuesve të DVV International Kosova, si dhe përfaqësuesve të MASHTI-t dhe MKRS-së. Në Kamenicë, pjesëmarrës ishin edhe organizata tjera si: Qendra e Aftësimit Profesional (QAP) - Gjilan, IAAP “Andrea Durrsaku”, Parku Teknologjik - Cactus Education, 3Media (Powered by Proactive).



Foto 15: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Kamenicë



Foto 16: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Kamenicë



Foto 17: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Kamenicë

Aktivitetet e kësaj dite shërbyen si një platformë e hapur për qytetarët për të njohur programet arsimore, për të diskutuar mundësitë e zhvillimit profesional dhe për të promovuar rëndësinë e mësimit gjatë gjithë jetës në komunitetet lokale.

Një punëtori profesionale me temën “Përdorimi i platformës EPALE” u organizua në ambientet e MASHTI-së (10:30–12:00) nga Shërbimi Kombëtar Mbështetës për EPALE (NSS Kosovo), në kuadër të Javës për Mësim Gjatë Gjithë Jetës. Qëllimi i aktivitetit ishte ofrimi i udhëzimeve praktike për shfrytëzimin e platformës EPALE në promovimin e arsimit të të rriturve dhe mësimit gjatë gjithë jetës.

Punëtorja mbledhi përfaqësues të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional, ofrues të arsimit për të rritur, organizata edukative dhe institucione shtetërore. Aktiviteti u hap me fjalë përshëndetëse nga: znj. Mimika Dobrosi (Erasmus+ / EPALE), znj. Ryve Prekorogja (MASHTI), z. Ramadan Alija (DVV International), të cilët theksuan rëndësinë e EPALE-s për zhvillimin profesional, rritjen e cilësisë së programeve dhe bashkëpunimin evropian. Po ashtu, u prezantuan aktivitetet e Javës për Mësim Gjatë Gjithë Jetës të organizuara nga Rrjeti ALE NK. Gjatë sesionit, Znj. Kristina Zimaj - Zyrtare e Projektit për EPALE Kosovo prezantoi funksionet kryesore të platformës, statistikën e përdorimit në Kosovë dhe Evropë, temat prioritare për vitin 2025, si dhe mënyrat e publikimit të përmbajtjes profesionale, përfshirë përdorimin e mjetit “Partner Search”.

Në përmbyllje, pjesëmarrësit kryen regjistrimin e tyre në EPALE, duke bërë hapin e parë drejt shfrytëzimit të plotë të mundësive që ofron platforma për zhvillim profesional dhe bashkëpunim.



Foto 18: Punëtoria
“Përdorimi i platformës
EPALE” gjatë Javës së
Mësimit Gjatë Gjithë Jetës




Foto 19: Punëtoria
“Përdorimi i platformës
EPALE” gjatë Javës së
Mësimit Gjatë Gjithë Jetës

Episodi i parë i serisë podcast “EDU-CAST”, i realizuar nga OJQ THY / YALEC Prizren, ofroi një bisedë me Z. Kujtim Gashi, Nënkryetar i Komunës së Prizrenit, mbi rëndësinë e mësimit gjatë gjithë jetës. Gjatë episodit u diskutuan mundësitë arsimore për të rinjtë dhe të rriturit, si dhe vizioni për zhvillimin e komunitetit dhe roli i arsimit si një motor kyç për zhvillimin lokal.




Foto 20: Episodi i parë i podcast-it “EDU-CAST” me Z. Kujtim Gashi, Nënkryetar i Komunës së Prizrenit.

Gjithashtu, gjatë kësaj dite, aktivitetet e organizuara kontribuan në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e mësimit gjatë gjithë jetës dhe nxitën pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në programe arsimore dhe trajnime profesionale.

E Mërkurë, 26 Nëntor 2025 – Promovime dhe Podcast-e

- Aktivitetet promovuese nga institucionet dhe OJQ-të e komunës së Ferizaj dhe Gjakovës
- Podcast nga YALEC Vushtrri: “Arsimi për të Rritur në Qendrën YALEC Vushtrri”

Aktivitetet e ditës së mërkurë, në kuadër të Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ), u përqendruan në promovimin publik të arsimit për të rritur dhe në transmetimin e podcasteve tematike që trajtojnë zhvillimet bashkëkohore në fushën e të nxënës dhe zhvillimit profesional.

Promovimet u organizuan në dy lokacione kryesore: Ferizaj tek sheshi i këmbësorëve, ku institucionet pjesëmarrëse ishin: Qendra e Aftësisimit Profesional (QAP), Qendra e Kompetencës (QK), IAAP “Pjetër Bogdani”, Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) - Prishtinë, IAPP “Zenel Hajdini” si dhe Qendra Rinore.

Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) është angazhuar në Javën e të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) në Kosovë, duke kontribuar si partner aktiv në kuadër të Rrjetit për Arsimin e të Rriturve në Kosovë (ALE NK). Pjesëmarrja e IPK-së u realizua përmes aktiviteteve publike, ku prezantuan materiale informuese dhe botime shkencore që adresojnë tema kyçe në fushën e arsimit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Gjatë ditës së parë të JMGJJ-së, IPK-ja ka kontribuar me prezencën e saj në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë. Aktivitetet e Institutit kanë vazhduar më 26 dhe 27 nëntor në komunën e Ferizajt dhe Podujevës, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe organizatat partnere, duke forcuar rolin e arsimit të të rriturve në nivel kombëtar.



Foto 21: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Ferizaj



Foto 22: Promovimi i Javës së Mësimi Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Ferizaj

Në kuadër të Javës së Mësimi Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ), më 26 nëntor 2025, në sheshin qendror të Gjakovës u mbajt aktivitet informues dhe promovues mbi ofertat arsimore për të rriturit. Qëllimi ishte të prezantohen mundësitë e mësimi, trajnimit dhe zhvillimit profesional që ofrohen në komunë.

Institucionet pjesëmarrëse:

- QAP Gjakovë prezantoi programet e aftësimit profesional në fusha teknike dhe praktike.
- SHMLT “Nexhmedin Nixha” shpalosi drejtimet teknike dhe projektet praktike të nxënësve.
- SHMLE “Kadri Kusari” ofroi informata për programet ekonomike, juridike dhe administrative.
- KVRL Gjakova prezantoi aktivitetet për të rinjtë dhe trajnimet joformale.

Gjatë Javës së Mësimi Gjatë Gjithë Jetës, në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës morën pjesë edhe Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP). QAP-et ofrojnë trajnime falas në profesione të ndryshme, duke vënë theks të veçantë në zhvillimin e aftësive praktike dhe aplikimin e njohurive në situata reale të punës.

DVV International Country Office Kosovo
Str. Rexhep Mala, Nr. 26
Prishtina 10 000 Kosovo

Përmes këtyre trajnimeve institucionale, pjesëmarrësve u mundësohet të fitojnë aftësi të reja dhe të përditësuara profesionale, me qëllim rritjen e mundësive për punësim, avancim ose mbajtje të vendit të punës.



Foto 23: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGGJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Gjakovë



Foto 24: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Gjakovë

Në të dy qytetet, institucionet arsimore, qendrat e aftësimi profesional dhe organizatat lokale prezantuan programet dhe shërbimet e tyre, shpërndanë materiale informuese dhe bashkëbiseduan me qytetarët rreth mundësive të të nxëniti dhe trajnimit profesional. Aktivitetet u karakterizuan nga pjesëmarrje e lartë e publikut dhe interesim i veçantë për programet që ofrojnë mundësi reale për zhvillim personal dhe profesional në komunitet.

Në po të njëjtë ditë, OJQ Hareja / YALEC Vushtrri transmetoi podcast-in e radhës në orën 13:00, me temën: “Arsimi për të Rritur në Qendrën YALEC Vushtrri”, ku u diskutua qasja, programet e ofruara dhe ndikimi i qendrës në komunitet.

Ky podcast u realizua në kuadër të Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës në Kosovë (JMGJJ 2025), e zhvilluar nga 24 deri më 27 nëntor 2025, me mbështetjen e DVV International Kosovë.

Podcasti përfshiu pjesëmarrjen e:

- OJQ HAREJA / YALEC - Drejtori Bajrush Kosumi,
- DKA Vushtrri - Enver Bajrami,
- Prof. Agron Ibrahim (Rrobaqepësi),
- Prof. Arben Halili (Gjuhë Gjermane),
- Storie Suksesi nga fusha e Edukimit Shëndetësor (Aerobikë),
- Storie Suksesi nga fusha e Rrobaqepësisë.

Në këtë episod u trajtuan temat kryesore:

- Rëndësia e arsimit për të rritur,

DVV International Country Office Kosovo
Str. Rexhep Mala, Nr. 26
Prishtina 10 000 Kosovo

- Mundësitë arsimore dhe zhvillimore në komunitet,
- Qasja dhe roli i qendrave për mësim gjatë gjithë jetës.

Ky aktivitet kontribuoi në promovimin e arsimit të të rriturve dhe fuqizimin e qytetarëve përmes programeve gjithëpërfshirëse të mësimi dhe zhvillimit profesional.



Foto 25: Podcast-i i realizuar nga YALEC Vushtrri me temën “Arsimi për të Rritur në Qendrën YALEC Vushtrri

Gjatë Javës së Mësimi Gjatë Gjithë Jetës, EduCast realizoi episodin e dytë të serisë së podcasteve, ku pjesëmarrëse ishte Znj. Edona Tortulla Rada, Drejtoreshë e Qendrës së Kompetencës Prizren. Në këtë episod u diskutua rendësia e zhvillimit të aftësive praktike dhe mësimi i bazuar në përvojë, si dhe mënyrat për të frymëzuar të rinjtë dhe të rriturit të angazhohen në mësim të vazhdueshëm. Podcasti shërbeu si një platformë për ndarjen e praktikave të mira dhe promovimin e kulturës së të nxënit gjatë gjithë jetës në komunitet.




Foto 26: Sesioni “Rëndësia e zhvillimit të aftësive praktike dhe mësimin e bazuar në përvojë” Znj. Edona Tortulla Rada, Drejtoreshë e Shkollës së Kompetencës “11 Marsi” në Prizren,

Këto aktivitete synuan të fuqizojnë kulturën e të mësuarit të vazhdueshëm, të rrisin qasjen në informim dhe të promovojnë praktika inovative në arsimin e të rriturve.

E Enjte, 27 Nëntor 2025 – Dita Përmbyllëse e Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës

- Aktivitetet promovuese nga institucionet dhe OJQ-të nga komuna e Podujevës
- Podcast nga YALEC Prizren, mysafir Veton Xhelili nga Cactus Education
- Përmbledhja e aktiviteteve dhe reflektimet e pjesëmarrësve
- Vlerësimi i kontributit të institucioneve dhe organizatave pjesëmarrëse

Dita e enjte shënoi përmbylljen e aktiviteteve të Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) në Kosovë, me një sërë ngjarjesh promovuese dhe diskutimesh tematike të organizuara në Podujevë dhe Prizren.

Aktivitetet përmblylëse u zhvilluan në sheshin e këmbësorëve në Podujevë, ku u prezantuan oferta të ndryshme arsimore dhe programe të orientuara drejt të mësuarit gjatë gjithë jetës. Përfaqësues komunalë mbajtën fjalë rasti, duke theksuar rëndësinë e qasjes gjithëpërfshirëse në

arsim dhe trajnimin profesional. Institucionet pjesëmarrëse: IAAP “Fan S. Noli” - Podujevë, Qendra e Aftësimit Profesional (QAP) - Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK), IAAP “Isa Boletini”, Flutura Academy.



Foto 27: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Podujevë



Foto 27: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Podujevë



Institucionet dhe organizatat pjesëmarrëse shpërndanë materiale informuese, broshura dhe fletëpalosje, duke i ofruar qytetarëve të Podujevës informacione të drejtpërdrejta mbi mundësitë e arsimit formal, joformal dhe trajnimet profesionale të përshtatura për grupe të ndryshme moshe. Aktiviteti pati për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit për rëndësinë e mësimit të vazhdueshëm dhe përfitimeve që sjell ai në zhvillimin personal dhe profesional.

Foto 28: Promovimi i Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) përmes standeve të ofruesve të arsimit gjatë gjithë jetës në Podujevë

Në përmbyllje të ditës u transmetua episodi i fundit i serisë së podcasteve EDU-CAST, i realizuar nga YALEC Prizren. EDU-CAST ofron një hapësirë të veçantë për diskutime mbi arsimin dhe zhvillimin e të rinjve dhe të rriturve. Në këtë episod, Veton Xhelili nga Cactus Education ndau perspektiven e tij mbi përdorimin e mjeteve digjitale në arsimin formal dhe joformal, si dhe theksoi rëndësinë e zhvillimit të aftësive digjitale për të rinjtë dhe të rriturit në epokën moderne. Ky episod përforcoi rolin e teknologjisë dhe inovacionit në procesin e të nxënës, duke ofruar udhëzime praktike për edukatorët dhe pjesëmarrësit në komunitet.



Foto 29: Episodi përfundimtar i podcast-it EDU-CAST nga YALEC Prizren, me Veton Xhelili nga Cactus Education

Gjatë tërë javës, qytetarët patën mundësinë të njiheshin nga afër me ofertat arsimore, programet profesionale dhe iniciativat zhvillimore të ofruara nga institucionet publike, qendrat e aftësimit profesional, shkollat profesionale dhe organizatat partnere të Rrjetit ALE NK. Këto aktivitete krijuan një hapësirë të hapur informimi dhe ndërveprimi, duke mundësuar prezantimin e qartë të mundësive të të mësuarit për të gjitha moshat dhe nevojat profesionale.

Përfundim

Java e Mësimi Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) 2025, e zhvilluar nga 24 deri më 27 nëntor, përmbylli me sukses një sërë aktiviteteve gjithëpërfshirëse që synuan promovimin e kulturës së të nxënit të vazhdueshëm në mbarë Kosovën. E organizuar nga Rrjeti për Arsimin e të Rriturve në Kosovë - ALE NK, në bashkëpunim dhe me mbështetje nga DVV International Kosova, kjo javë mobilizoi një gamë të gjerë institucionesh qendrore e lokale, organizatash të shoqërisë civile dhe ofruesish të arsimit formal e joformal, duke reflektuar një angazhim të përbashkët për forcimin e arsimit për të rritur.

Gjatë katër ditëve të aktivitetit, u theksua roli kyç i të mësuarit gjatë gjithë jetës si një komponent thelbësor për zhvillimin personal, profesional dhe shoqëror, sidomos në një periudhë transformimesh të shpejta teknologjike, digjitale dhe ekonomike. Programi i JMGJJ 2025 vuri në pah rëndësinë e një qasjeje të integruar që përfshin arsimin formal, joformal dhe informal, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme, konkurruese dhe të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës.

Gjatë Javës së Mësimi Gjatë Gjithë Jetës, aktivitetet u zhvilluan në disa komuna të vendit përmes prezantimeve, promovimeve publike, podcasteve tematike, sesioneve informuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere në hapësira publike. Qytetarëve iu ofruan informacione mbi programet arsimore, trajnimet profesionale dhe mundësitë për përfshirje në arsimin për të rritur, ndërsa institucionet prezantuan praktikatat e tyre përmes materialeve informuese dhe diskutimeve të hapura.

Kjo javë kontribuoi dukshëm në:

- *forcimin e kulturës së të nxënit të vazhdueshëm,*
- *rritjen e ndërgjegjësimi publik për rëndësinë e arsimit gjatë gjithë jetës,*
- *fuqizimin e qytetarëve përmes qasjes në mundësi zhvillimi,*
- *zgjërimin e pjesëmarrjes në programe arsimore dhe profesionale,*
- *promovimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të praktikave të mira.*

JMGJJ 2025 shërbeu si një platformë e rëndësishme për dialog, bashkëpunim dhe reflektim mbi mënyrat se si arsimi për të rritur mund të zhvillohet më tej dhe të bëhet më i aksesueshëm për të gjithë. Veprimtaria e këtij edicioni vendosi baza të forta për iniciativat e reja, projekte të qëndrueshme dhe politika më gjithëpërfshirëse në fushën e arsimit gjatë gjithë jetës në Kosovë.

Java e Mësimi Gjatë Gjithë Jetës, si nismë kombëtare, vazhdon të mbetet një nga mekanizmat kryesorë për promovimin e kulturës së të nxënit dhe për nxitjen e zhvillimit të vazhdueshëm të të rinjve, të rriturve dhe komuniteteve në tërësi. Rezultatet e këtij viti dëshmojnë përkushtimin e sektorit të arsimit dhe të gjithë aktorëve të përfshirë për të avancuar një vizion të përbashkët: një shoqëri që mëson, zhvillohet dhe përparon në çdo hap.

Rekomandime të dala nga Java e Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) 2025

- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional
- Rritja e fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere për qytetarët
- Zgjerimi dhe diversifikimi i ofertës edukative për të rritur
- Përdorimi i platformave digjitale për zhvillim profesional dhe mësim
- Përfshirje më e gjerë e komunave dhe institucioneve lokale
- Monitorim dhe vlerësim i rregullt i aktiviteteve dhe rezultateve
- Rritja e investimeve në arsimin e të rriturve dhe AAP
- Përfshirja aktive e të rinjve dhe grupeve të cenueshme në aktivitetet edukative